



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 29

Tiranë – E hënë, 5 gusht 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nr. 7086/1, datë 1.8.2019	Për publikimin e thirrjes për projekt-propozime në fushën e turizmit..... 3
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 72, datë 1.8.2019	Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës “Supply Supply And Installation Of Regional Hospital Information System (Rhis) Including Training”..... 8
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, nr. 2469, datë 1.8.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Shpresa Halit”..... 11
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, nr. 6772, datë 31.7.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Sildo & Arli” sh.p.k..... 13
Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Qendër, nr. 6785, datë 31.7.2019	Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit “Basura” sh.p.k..... 14

**KËRKESË****Nr. 7086/1, datë 1.8.2019**

**PËR PUBLIKIMIN E THIRRJES PËR
PROJEKT-PROPOZIME NË FUSHËN E
TURIZMIT**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit shpall thirrjen për përfitimin e mbështetjes financiare të projekteve në fushën e turizmit nga data 5.8.2019 deri më datën 4.9.2019. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, duke inkurajuar zgjerimin e sezonit turistik nëpërmjet promovimit të destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore vendase, si dhe duke diversifikuar me modele inovative produktet turistike. Duke pasur parasysh këto objektiva kryesore, thirrja e dytë e këtij viti është e ndarë në dy tematika:

1. Promovimin e destinacioneve turistike e të vlerave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore të vendit tonë.

Nën këtë tematikë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Zgjerimin e aktiviteteve dhe ofertave turistike, duke synuar forcimin apo krijimin e produkteve të reja turistike, që shkojnë për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme.

- Përfshirjen gjithnjë e më shumë në sektorin e turizmit të komuniteteve lokale, studentëve në promovimin përmes produktit turistik sipas karakteristikave të destinacioneve turistike.

- Promovim e produkteve turistike shqiptare.

2. Zhvillimi/përmirësimi/përgatitja e studimeve apo modeleve të produkteve turistike specifike në përputhje me kërkesën gjithnjë në rritje për paketa inovative, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese, përveç shërbimeve bazë standarde.

Nën këtë tematikë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të vecantë me synim: zhvillimin e ekonomisë së detit, argëtimin; shkëmbimin e eksperiencës.

- Zhvillimin e produktit turistik gjatë gjithë vitit në lidhje me veprimtari të ndryshme turistike me tematikë: gastronominë, zonat rurale, etnografinë, trashëgiminë kulturore, trashëgiminë natyrore etj.

ANEKSI 1

**FORMULARI I APLIKIMIT PËR
PËRFITIMIN E MBËSHTETJES
FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET
NË FUSHËN E TURIZMIT**

Pjesa I: Informacione të përgjithshme

Titulli i projektit: [Type text]

Aplikanti (emri i personit fizik/juridik që aplikon/partneri 1): [Type text]

Statusi ligjor i subjektit që aplikon: [Type text]

Numri i regjistrimit të subjektit që aplikon: [Type text]

Vendi i regjistrimit të subjektit që aplikon: [Type text]

Data e regjistrimit të subjektit që aplikon: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

Pozicioni i personit të kontaktit: [Type text]

Tel: [Type text]

E-mail: [Type text]

Kohëzgjatja e projektit: nga data [Type text] deri në datën [Type text]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [Type text]

Fusha dhe tema e projektit: [Type text]

Buxheti total: [Type text]

Fondet e kërkuara: [Type text]

Pjesa II: Përshkrimi i projektit

1. Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe

argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuar (Maksimumi 10 rreshta).

2. Objektivat e projektit: (Maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv):

2.1. [Type text]

2.2. [Type text]



2.3. [Type text]

2.4. [Type text]

2.5. [Type text]

3. Lloji i aktiviteteve sipas fushës si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (Maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet):

3.1. [Type text]

3.2. [Type text]

3.3. [Type text]

3.4. [Type text]

3.5. [Type text]

4. A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? (Maksimumi 5 rreshta):

[Type text]

5. A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve? (Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

6. Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? (Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmbledhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

7. Qëndrueshmëria e projektit - impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si personit fizik/juridik që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

8. Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Pjesa III: Partnerët (nëse ka)

Bashkërendirni i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 1 (Aplikanti)

a. Misioni. Cili është misioni i subjektit tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

b. Struktura. Përshkruani strukturën e subjektit duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

c. Financimi. Si financohet subjekti juaj dhe cili ishte buxheti i tij për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 2

Emri i personit fizik/juridik: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Pjesa IV: Buxheti

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruar dhe të mundshme?



Lloji i shpenzimit	≠ e njësisë	Çmimi	TOTAL	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-	MTM
I. Shpenzimet direkte të projektit							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
Totali i shpenzimeve direkte							
II. Shpenzimet administrative (deri në 15% nga totali i kërkuar)							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
Totali i shpenzimeve administrative:							
TOTAL (edhe në %) ¹							

Vini re! Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

¹ Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë dhe MTM dhe vetë aplikantin, qoftë ky individ apo organizatë), edhe si % e buxhetit total për projektin.



ANEKSI 2

PROCEDURAT PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET NË FUSHËN E TURIZMIT

Ministria përgjegjëse për turizmin, nëpërmjet fondeve të parashikuara në buxhetin e shtetit, financon projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit, të paraqitura nga persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, private apo publikë që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin.

I. Thirrja për aplikim

Shpallet thirrja për përfitimin e mbështetjes financiare në lidhje me projektet në fushën e turizmit, në faqen zyrtare të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në media si dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, sipas formatit bashkëlidhur.

II. Kriteret e pjesëmarrjes

Subjektet pjesëmarrëse duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in, si dhe dokumentet që vërtetojnë se:

a) Nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit; (Vërtetim nga Gjykata, Zyra Përmbarimore)

b) Nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga Gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme; (Vërtetim nga Gjykata)

c) Nuk janë dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksioner i shoqërisë; (Vërtetim nga Gjykata dhe vërtetim të gjendjes gjyqësore)

ç) Kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; (Vërtetim nga Tatimet)

d) Kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës; (Vërtetim nga Tatimet)

2. Të paraqesin argumente në mbështetje të propozimeve që justifikojnë financimin e projekteve të rëndësishme të paraqitura prej tyre.

3. Të demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100 % të të gjitha kostove të projektit të propozuar përpara përfundimit të tij, provuar me kopje të certifikuara të balanceve të dy viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatese dhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licensuar auditimi dhe kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

4. Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

Kur aplikuesi është i huaj ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kriteret e renditura me sipër. Nëse dokumentat e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.

5. Aplikuesi duhet të paraqesë edhe dokumentet e mëposhtme:

a) Nëse aplikon si person fizik, duhet të paraqitet një CV dhe një portofol të veprimtarisë së aplikuesit.

b) Nëse aplikon si person juridik, duhet të paraqitet një CV të subjektit dhe një portofol të veprimtarisë së tij të deritanishme.

6. Në projektet që do të përzgjidhen, subjektet duhet të përfshijnë:

a) qëllimin e projektit

b) vendin e ushtrimit të veprimtarisë

c) veprimtarinë që do të kryhet

ç) çmimet e referencës për të gjitha aktivitetet që mund të nënkontraktohen

d) mënyrën e menaxhimit të projektit dhe sistemin e monitorimit e të vlerësimit të tij

e) treguesit e verifikueshëm dhe rezultatet e pritshme të projektit.

III. Metoda e aplikimit

1. Formulari i aplikimit (të cilin mund ta gjeni më poshtë në formatin Word ose PDF), pasi të plotësohet, duhet të dërgohet në adresën e emailit: info@turizmi.gov.al brenda orarit zyrtar:



E hënë – E enjte 08:00-16:30

E premte 08:00-14:00

Shkarko formularin docx.

<https://mjedisi.gov.al/>

Shkarko formularin pdf. <https://mjedisi.gov.al/>

Përveç formularit të plotësuar, në këtë adresë nuk duhet të dërgoni asnjë material tjetër.

2. Formulari i aplikimit i plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës referuar pikës II, duhet të dorëzohet në tre kopje pranë zyrës së protokollit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Albania.

Pas dorëzimit të dokumentacionit shoqërues të aplikimit nuk është e mundur të tërhiqet dokumentacioni nga arkiva e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2.1 Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar: Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Aplikim për përfitimin e mbështetjes financiare në fushën e turizmit; Emri i aplikantit; Titulli i projektit

3. Thirrja për kërkesë-propozimet për mbështetjen financiare në fushën e turizmit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është e hapur brenda 30 ditëve nga data 5.8.2019 dhe mbyllet më datën 4.9.2019 në përfundim të orarit zyrtar ora 16:30. Çdo aplikim apo dokumentacion i paraqitur pas kësaj date dhe këtij orari nuk pranohet.

4. Në përllogaritjen e kohëzgjatjes së projektit do të konsiderohet procesi i plotë i aplikimit deri në firmosjen e kontratës sipas afateve të përcaktuara. Për këtë thirrje, projektet fituese nuk mund të fillojnë para datës 4.10.2019 dhe duhet të përfundojnë deri më 31.12.2019.

IV. Financimi

1. Fondi në dispozicion për këtë thirrje për projekt-propozime është 34 172 000 Lekë me TVSH.

2. Për realizimin e projekteve kokurruese turistike, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuar e të miratuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Projektet për të cilat kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Financimi nga Buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkures.

4. Shpenzimet e nevojshme për shpërblimin e ekspertëve të pavarur do të mbulohen nga fondi buxhetor i parashikuar për mbështetjen financiare të projekteve turistike.

5. Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

V. Procesi i vlerësimit

1. Procesi i vlerësimit të kërkesë-propozimeve për mbështetjen financiare në fushën e turizmit zgjat 15 ditë pune.

2. Procesi i vlerësimit do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.5.2018 "Për përcaktimin e anëtarëve të Komisionit të Përzgjedhjes së Projekteve".

3. Çdo propozim kalon nëpër dy faza të vlerësimit:

a) vlerësimi i personit fizik/juridik;

b) vlerësimi i projekt-propozimit (formulari i aplikimit të propozimit).

3.a. Në procesin e vlerësimit të personit fizik/juridik që paraqet kërkesën do të merren parasysh:

i) profili dhe reputacioni i personit fizik/juridik dhe kapaciteti zbatues/menaxhues i tij;

ii) veprimtaria e deritanishme dëshmon se personi fizik/juridik ka në objekt të veprimtarisë së tij/saj turizmin dhe fushat e lidhura me të;

iii) misioni i personit fizik/juridik dhe objektivat e veprimtarisë së tij të deritanishme përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

iv) personi fizik/juridik ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;

v) personi fizik/juridik ka treguar qëndrueshmëri dhe është rritur me kalimin e viteve;

vi) personi fizik/juridik ka kontribuar në fushën ku operon me produkte të rëndësishme;

vii) personi fizik/juridik ka kapacitetin në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertizën teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin;

Kriteret e mësipërme nuk duhet të shkurajojnë persona fizik/juridik të rinj, të cilët mund të përmbushin kriteret e tjera;



3.b. Në procesin e vlerësimit të projekt-propozimit (formulari i aplikimit të propozimit) do të merren parasysh:

i) projekti i propozuar ka në objekt të veprimtarisë së tij turizmin dhe fushat e lidhura me të;

ii) objektivat e projektit të propozuar përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

iii) problematika e identifikuar është aktuale dhe argumentimi i nevojës për projektin e propozuar është bindës;

iv) objektivat e projektit të propozuar përputhen me problematikën e identifikuar;

v) origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve të planifikuara;

vi) aktivitetet e planifikuara përputhen me objektivat e projektit dhe hapat e zbatimit të projektit janë të qarta dhe përfundojnë brenda datës 31.12.2019.

vii) shpërndarja e resurseve dhe bashkërendimi i punës midis partnerëve është efikas;

viii) treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;

ix) përpilimi i kostove financiare: kostot janë reale (çmimet janë të bazuara në referenca që aplikanti mund t'i argumentojë) dhe të justifikueshme (raporti kosto/rezultat është i pranueshëm);

x) niveli i bashkëpunimit me persona fizikë/juridikë të tjerë, si dhe bashkëfinancimi;

4. Komisioni klasifikon dhe përzgjedh projektet në fushën e turizmit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune, pas përfundimit të afatit 30 (tridhjetë) ditë të parashikuar për paraqitjen e dokumentacionit nga subjektet e interesuara që kanë paraqitur kërkesë-propozime për mbështetje financiare.

5. Ministri, brenda 5 (pesë) ditësh pas paraqitjes së propozimeve nga Komisioni, miraton projektet në fushën e turizmit, të cilat do të përfitojnë financim.

6. Nëse kërkesë-propozimi përzgjidhet nga Komisionin i Përzgjedhjes së Projekteve dhe miratohet nga ministri, procedohet me njoftimin e aplikuesit brenda 2 (dy) ditëve për nënshkrimin e kontratës.

7. Nënshkrimi i kontratës kryhet nga ministri ose një person tjetër i autorizuar prej tij.

8. Procesi i monitorimit kryhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të projektit.

KËRKESË

Nr. 72, datë 1.8.2019

PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS “SUPPLY SUPPLY AND INSTALLATION OF REGIONAL HOSPITAL INFORMATION SYSTEM (RHIS) INCLUDING TRAINING”

Invitation for Bids (IFB)

Issued on 31st of July 2019

Albania

Health System Improvement Project

Loan No. 8466-AL

Identification No. P144688

Supply and Installation of Regional
Hospital Information System (RHIS)
including training HSIP/G/ICB/ 02-2017

1. This Invitation for Bids (IFB) follows the General Procurement Notice (GPN) for this project that appeared in UNDB online on 22nd of October 2015.

2. The Government of Albania has received a loan from the International Bank for Reconstruction and Development toward the cost of the Health System Improvement project in Albania and it intends to apply part of the proceeds of this **loan** to payments under the agreement(s) resulting from this IFB: Supply and Installation of Regional Hospital Information System (RHIS) including training HSIP/G/ICB/ 05-2019.

3. The Ministry of Health and Social Protection Albania, serves as the implementing agency for the project and now invites sealed bids from eligible Bidders for Supply and Installation of Regional Hospital Information System (RHIS) including training



HSIP/G/ICB/05-2019 .The computerization of regional hospitals has as its objective:

The computerization of regional hospitals has as its objective:

- Increasing the quality and safety of patient service
- Good governance of public funds and investments
- Reduction of informality
- Improving the quality and efficiency of political, management and financial decisions
- Citizens' ability to access their medical records

With the introduction of an Integrated Information System (Hospital Information System - HIS) in all links of medical services in regional hospitals, it will be possible to: increase the quality of patient medical records, establish a database with medical records of patients create a much faster and more accurate access to patient health records, increase the efficiency of medical care professionals, and enable analyzes of morbidity, death, emergencies, geographic areas, age, gender etc. Also, the management of drugs and medical materials in every hospital branch from the moment of supply to the patient's consumption will increase the monitoring, control and traceability of the use of drugs and medical materials, the management of medical services with an integrated system such as HIS will bring a control and good management of the secondary income. The IT system will strengthen the implementation of orders and regulations set by the Hospital itself, the Ministry of Health and Social Protection, enabling transparency and control at all phases of providing the patient health service with the four-eye principle.

4. Bidding will be conducted using the International Competitive Bidding (ICB) procedures specified in the World Bank's Guidelines: Procurement under IBRD Loans and IDA Credits, edition of 2011 revised in July 2014, and is open to all Bidders eligible as defined in these Guidelines, that meet the following minimum qualification criteria:

- Bidder (an individual firm or joint venture - JV) must have been in operation in all the

following fields: database application software, management information system, and proven capability to provide, design, installation, warranty and support of production system (system components) in accordance with this Contract for a period of minimum five (5) years (2014, 2015, 2016, 2017, and 2018). The leader of the JV should have been active in each of those fields.

- During the past five (5) years (2014, 2015, 2016, 2017, and 2018) the Bidder (an individual firm submitting the bid or jointly within the joint venture) must have completed at least two (2) successful contracts involving in each of those contracts all of the following activities: supply, development, installation and post-sales support for an integrated system for a client, which was a government entity. Those reference systems should be fully operational at the date of issuing these bidding documents. In case of a JV, the leader should have completed at least one of those contracts.

- Bidder shall demonstrate availability of liquid assets of at least **484,000 Euro (four hundred eighty four thousand Euro)** at the date of issuing these bidding documents.

- Bidder (an individual firm or jointly the joint venture) shall demonstrate average annual turnover of at least **1,937,000 Euro (one million nine hundred thirty seven thousand Euro)** in last three (3) calendar years (2016, 2017, and 2018).

- Bidder shall provide training in Purchaser's country/, associated with the operation and administration of the system, as well as for all developed and installed products. Language of trainings will be Albanian language. Details on training given in R12.2.

- Bidder shall have an office in the Purchaser's country or have a partner that is registered as a legal entity in the Purchaser's country having official status of a developer / provider partner, or having a consortium agreement associated with this Contract. This is necessary during the implementation, deployment, training, warranty period for smooth and reliable implementation of the Contract.

- Bidder must demonstrate technical competencies with at least IT staff members/consultant certified in the following



fields, combined to fulfill the following requirements. (One staff member could play the role of more than one specialist, but no more than 2 positions, when holding the required certificates as below):

- At least one (1) Business Analyst and Software Architect with a minimum of 5 years of experience in IT projects in e-health and experience in at least one similar project;

- At least one (1) Project Manager with at least 5 years of proven experience in the relevant field, holding a valid certification in Project management such as PMP (Project Management Professional) or equivalent. The Project Manager shall be available in Albania during the whole project timeline;

- At least two (2) Specialists certified in ITIL framework;

- At least two (2) specialists certified for managing and administering the relational database technology;

- At least two (2) specialists certified with professional level for service oriented architecture non vendor related;

- At least one (1) specialist (Information Technology) with at least 3 years of experience

- with: HL7, CDA (R2), IHE standards;

- At least five (5) developer specialists certified in the developing technology used in the project proposal (for example MCSD if the solution is in Microsoft);

- At least one (1) certified User Interface Designer, with at least 3 years' experience;

- At least two (2) Testing Specialists with at least 3 years of experience and certified in software testing;

- At least three (3) Experts on Training with at least 3 years of proven experience in education or certified in IT training;

- At least two (2) specialists with medical and/or pharmaceutical and/or nursery with at least 3 years' experience in healthcare sector;

- At least two (2) specialists with proven skills in interoperability technologies;

- At least two (2) specialists with proven skills in Business Intelligence and Reporting solutions;

- At least two (2) specialists with proven skills in Middleware technologies;

- The Bidder must have in the working team, at least 2(two) consultants with experience in the

healthcare field with documented experience in the implementation of a nationwide for health systems, in at least 1(one) EU country. The bidder should provide the CV-es of the consultants and signed agreement confirming the availability of these consultants throughout the implementation phase.

- The Bidder shall provide all software licenses for all components and products offered, demonstrating the software owner's permission to use the offered products for the contract.

- Plan - schedule of services shall be authorized by the Purchaser and signed by the Purchaser within twenty (20) business days after signing the contract. Supplier shall promptly provide services by approved schedule.

- In the case of foreign companies participation, consortium is the most likely appropriate form of participation in the tender (although not mandatory), because some of the requirements involve knowledge and skills that international suppliers may not have – experience of work in the country. The bidder must declare its local support during implementation, installation, training and warranty.

- Vendors shall have at least on certificate out of the following list: ISO 9000 series, ISO 9001: 2015 or equivalent for quality management and ISO 27001:2013 or equivalent for managing information security (Bidder shall submit notarized copies of Certificate on compliance issued by the authorized body).

- The Bidder shall provide service and technical support and warranty, including new versions of the products in accordance with the R12.3 and R12.4.

- The Bidder shall prepare appropriate guidance for all components of the System in Albanian language.

- The Bidder shall have proven track record of working with the standards used in this document: HL7 (V2 or V3 or FHIR), CDA (R2), IHE

- The Bidder shall have proven capabilities, specialization or competency in Application Integrations, Application Development, Data Platforms.



5. Interested eligible Bidders may obtain further information from can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday:

Mrs. Blerina Dudushi – PCU Project Manager
Address: Rr. **“Aleksandër Moisiu”, Kati 2**
(Pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor)

City: **Tirana**

ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

Electronic mail address:

hsip.dudushi@gmail.com

6. A complete set of bidding documents in English are available free of charge. Interested Bidders are requested to send to the project coordination Unit (PCU) an email or letter to register their interest to participate in this bidding procedure. A complete set of the bidding documents will be sent upon receipt of that written or email application.

The request for Bidding documents must be submitted in the following address:

In attention to: Mrs. Blerina Dudushi – PCU Project Manager

Ministry of Health and Social Protection
Albania

Address: **Rr. Kavajës, Nr. 53, City: Tirana,**
ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

Electronic mail address:

hsip.dudushi@gmail.com

7. Bids must be delivered to the address below⁷ at or before **9th of October 2019 local time 12:00**. The amount of Bid Security required is **96,000 (Ninety six thousand) Euro**. Late bids will be rejected. Bids will be opened in the presence of Bidders' representatives who choose to attend at the address below:

In attention to: Mrs. Blerina Dudushi – PCU Project Manager

Ministry of Health and Social Protection
Albania

Address: **Rr. Kavajës, Nr. 53, City: Tirana,**
ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

Electronic mail address:

hsip.dudushi@gmail.com

8. The attention of prospective Bidders is drawn to (i) the fact that they will be required to certify in their bids that all software is either covered by a valid license or was produced by the Bidder and (ii) that violations are considered fraud, which can result in ineligibility to be awarded World Bank-financed contracts.

Blerina Dudushi – PCU Project Manager
Ministry of Health and Social Protection
Albania

Address: **Rr. Kavajës, Nr. 53, City: Tirana,**
ZIP Code: **1000**

Country: **Albania**

Electronic mail address:

hsip.dudushi@gmail.com

KËRKESË

Nr. 2469, datë 1.8.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT “SHPRESA HALIT”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e pezullimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“SHPRESA HALIT”

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Evisjon Salku



VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-TR-2019-000552-5

Datë: 18.7.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPUT-TR-2019-000552-2, datë 5.7.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin Shpresa Halit, me NIPT L61614011H, përfaqësues i autorizuar i subjektit Z. Rënea Shqau, me ID: I80328018G, punëtor, prej datës 5.7.2019, ora 14:00 deri më datën 5.7.2019, ora 16:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit më datën 5.7.2019 dhe e njoftoi më datën 5.7.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 29, pika 1/b/iii.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit

Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 500 000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Propozim për revokim leje mjedisore sipas ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit", i ndryshuar, neni 27, pika b dhe pezullim plotësisht të aktivitetit.

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

15.7.2019 - 1. Të dorëzojë pranë ISHMPUT-së, Tiranë, vetmonitorimin periodik çdo 6 muaj të protokolluar pranë ARM-së, Tiranë, përpara datës së inspektimit duke qenë se subjekti pretendon se i dispon. 2. Të dorëzojë pranë ISHMPUT-së, Tiranë, pagesën vjetore.

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Besmir Stafa ID:

Arjan Cela ID:

Kundër vendimit përfundimtar, subjekti “Shpresa Halit” ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

**KËRKESË**

Nr. 6772, datë 31.7.2019

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “SILDO & ARLI” SH.P.K**

ISHMPUT-ja, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të dënimit nga grupi i inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi

i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar “ka ndryshuar adresë”.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Qendër, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“SILDO & ARLI” SH.P.K

KRYEINSPEKTOR

Armando Lamaj



Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000293 - 5

Datë: 12/07/2019

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000293 - 2, datë 06/06/2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin SILDO & ARLI, NIPT L18508901H. Përfaqësues i autorizuar i subjektit Fitim Kaja, prej datës 05/06/2019 00:00 deri më datën 05/06/2019 00:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 06/06/2019 dhe e njoftoi në datë 06/06/2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore: Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 “PËR LEJET E MJEDISIT”, Neni Nr. 29 Pika 1/a/ii.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjoke 500000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

—

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Ersid Hasanllari ID: 0300020003

Alban Kostallari ID:

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti SILDO & ARLI ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

**KËRKESË**

Nr. 6785, datë 31.7.2019

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR
DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ
SUBJEKTIT “BASURA” SH.P.K**

ISHMPUT-ja, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të dënimit nga grupi i inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi

i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar “larguar”.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Qendër, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit të ISHMPUT-së, respektivisht për subjektin si më poshtë:

“BASURA” SH.P.K

KRYEINSPEKTOR

Armando Lamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT
DREJTORIA QENDRORE
VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000282 - 5

Datë: 02/07/2019

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe procesverbalin e inspektimit Nr. ISHMPUT-DQ-2019-000282 - 2, datë 31/05/2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “BASURA” SHPK, NIPT K48T08908H, Përfaqësues i autorizuar i subjektit SULEJMAN SINA, prej datës 27/05/2019 00:00 deri më datën 28/05/2019 00:00.

Grupi i inspektimit, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datë 31/05/2019 dhe e njoftoi në datë 31/05/2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore :
Ligji Nr. 10488, datë 14.07.2011 “PËR LEJET E MJEDISIT” Neni Nr. 29 Pika 1/a/ii.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit Nuk ka, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjohë 1000000 Lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t'u realizuar me afate kohore respektive:

=

Inspektorët Shtetëror të autorizuar:

Ersid Hasanllari ID: 0300020003Alban Kostallari ID:

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti “BASURA” SHPK ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Organit Epror”, Komisionit të Ankimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2019